



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kmshc.al



www.kmshc.al

30 Shtator 2024

NJOFTIM

NË KUADËR TË DITËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT: RËNDËSIA E TRANSPARENCËS PËR NJË ADMINISTRATË TË PËRGJEGJSHME DHE PROFESIONALE

Me rastin e 28 Shtatorit, Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit, në ambientet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u zhvillua një takim informues dhe ndërgjegjësues me përfaqësues nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky aktivitet kishte për qëllim theksimin e rëndësisë së transparencës si parim themelor për besueshmërinë dhe integritetin e institucioneve publike, duke synuar rritjen e besimit dhe mbështetjes së qytetarëve ndaj administratës publike.

Gjatë takimit, u diskutua mbi rolin e transparencës në sigurimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale, e cila bazohet në meritë, integritet moral dhe paanësi politike. Parimi i transparencës garanton siguri ligjore dhe përmirëson legjitimitetin në procesin e vendimmarrjes, duke ndikuar drejtpërdrejt në përgjegjshmërinë e administratës ndaj qytetarëve. Përmes transparencës, qytetarët kanë të drejtën të informohen mbi punën e institucioneve publike dhe të përfshihen në proceset e vendimmarrjes, duke kontribuar kështu në përmirësimin e reformës së administratës publike dhe në rritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe përgjegjshmërisë.



Legjislacioni për të drejtën e informimit, së bashku me atë për shërbimin civil, synon të formësojë një administratë publike të përgjegjshme dhe profesionale, që ofron shërbime cilësore dhe respekton të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve. Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i eksperiencave mes nëpunësve, njohja me praktikatat më të mira dhe identifikimi i pikave të përbashkëta të kuadrit rregullator, në ushtrimin e përgjegjësive përkatëse.

Një ndër çështjet kryesore të trajtuara ishte publikimi i informacionit dhe dokumentacionit të lidhur me vendimmarrjen e autoriteteve publike, në kuadër të transparencës proaktive. Diskutimet u fokusuan edhe në rolin e koordinatorëve për të drejtën e informimit, si dhe në zbatimin e saktë të legjislacionit për shërbimin civil, me një balancë të drejtë midis të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Ky bashkëpunim dhe ndërveprim mes stafeve të institucioneve të pavarura siguron një njohje më të zgjeruar të kornizës ligjore dhe procedurave, për të nxitur përgjegjshmërinë dhe integritetin në ushtrimin e kompetencave institucionale.